

VENDIM
Nr.241, datë 31.3.2011

**PËR KRYERJEN NGA “POSTA SHQIPTARE” SHA, TË SHËRBIMEVE
POSTARE, FINANCIARE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA, QË JANË NË
PËRPUTHJE ME VEPRIMTARINË E KËSAJ POSTE, PËR INSTITUCIONET E
QEVERISJES QENDRORE E VENDORE, INSTITUCIONET E TJERA
PUBLIKE**

(Ndryshuar me VKM nr. 81, datë 28.1.2015)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 7 të ligjit nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministria, ministritë, institucionet e sektorit publik, veprimtaria e të cilave mbështetet në pronën publike, shtetërore, institucionet e qeverisjes vendore, si për llogari të tyre, ashtu edhe në shërbim të shtetasve e anasjellas, të realizojnë nëpërmjet “Posta shqiptare” sh.a., këto shërbime:

- a) shërbimet postare;
- b) shërbimet financiare që nuk bien në kundërshtim me legjislacionin aktual;
- c) Shërbime, që janë në përputhje me veprimtarinë e “Posta Shqiptare” sh.a., të cilat ngarkohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve postare.

2. Institucionet e lartpërmendura, për shërbimet e tjera, të cilat janë në përputhje me veprimtarinë e “Posta Shqiptare” sh.a., si ofrues i parë, t’i drejtohen kësaj poste. Në rast se këto shërbime nuk realizohen nga “Posta Shqiptare” sh.a., atëherë mund t’u ofrohen operatorëve të tjerë.

3. Për shërbimet e ofruara, sipas këtij vendimi “Posta Shqiptare” sh.a., do të zbatojë tarifa të orientuara me vlerat e tregut.

4. Vendimi nr.414, datë 7.6.2006 i Këshillit të Ministrave “Për kryerjen nga “Posta Shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare dhe financiare të ministrive, institucioneve buxhetore, ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital shtetëror”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministri për Inovacion dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha